



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1314/1 Prot.

Durrës më, 19/07/2019

**VENDIM**

Nr 40 , datë 19.07.2019

**PËR**

**"PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË STANDARTEVE AKADEMIKE DHE CILËSISË, NË UAMD".**

Mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenin 36 dhe nenin 46 të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", statutin e UAMD, Vendimin nr. 61/1 datë 24.10.2017, Vendimin nr. 137 datë 27.09.2018, Vendimin nr 144 datë 05.11.2018 të Senatit Akademik, Vendimin nr. 126, datë 17.07.2018 të Senatit Akademik "Për miratimin e propozimit për përcaktimin e shpërblimit për komisionet e përhershme të UAMD", diskutimin e mbledhjes së Bordit më datën 27.06.2019, shkresën nr. 1116 prot., datë 26.06.2019 të Komisionit të Përhershëm të Standarteve dhe Cilësisë në UAMD, shkresën nr. 1240 prot, datë 11.07.2019 të Administratorit, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.07.2019,

**VENDOSI:**

1. Shpërblimin e punonjësve të emëruar në Komisionin e Përhershëm të Standarteve dhe Cilësisë në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Masa e shpërblimit të anëtarëve në përbërje të tij është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo muaj, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj.
3. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së punonjësve në përbërje të këtij komisioni, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit.
4. Ky vendim fillon efektet financiare nga janari 2019.

**Kryetar i Bordit të Administrimit**

Ilirjana

